



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1012/4 Prot.

Tiranë, më 13.05.2026

VENDIM

Nr. 71, datë 13.05.2026

**“PËR  
MIRATIMIN TESTEVE PRAKTIKE DHE NDRYSHIMET NË RREGULLOREN DHE  
DOKUMENTACIONIN MJEKËSOR TË KONKURSIT TË PRANIMIT NË  
PROGRAMIN E CIKLIT TË PARË BACHELOR NË “SHKENCA TË LËVIZJES” PËR  
VITIN AKADEMIK 2026-2027”**

Mbështetur në nenin 3 pika 4 gërma “b”, 38, 69 pika 3, 73, 74 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”; nenin 7 pika 4 gërma “b”, 20, 72, 74, të Statutit të UST; në vijim të shkresave nr. 916/1 Prot., datë 29.04.2026 dhe nr.995/2 Prot., datë 11.05.2026 të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Vendimit të Rektoratit nr. 74, datë 11.05.2026, Senati në mbledhjen e datës 13.05.2026;

V E N D O S I :

1. Miratimin e testeve praktike të pranimit në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes” për vitin akademik 2026-2027:
  - Testet praktike të pranimit për meshkuj;
  - Testet praktike të pranimit për femra;(bashkëlidhur)
2. Shtimin e pikës 20 në Rregulloren e Konkursit të pranimit si vijon:  
*“Kandidati konkurues duhet të marrë të paktën 10 (dhjetë) pikë në testimin praktik të konkursit. Nëse rezultati është nën këtë prag, kandidati nuk shpallet fitues dhe nuk fiton të drejtën e regjistrimit.*
3. Miratimin e ndryshimeve në kartelën mjekësore e cila duhet të përmbajë ekzaminimet e detyrueshme si më poshtë vijon:
  - Specialisti *kardiolog*
  - Specialisti *O.R.L.*
  - Specialisti *okulist*
  - Grup analiza: *gjak komplet, eritrocitet H, urinë komplet*
  - Specialisti *psikiatër/neurolog*(kartela bashkëlidhur)

4. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT**

**Prof. Dr. Agron KASA**

